

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i

Fjalimit të Xhumasë

të Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

Hazret Mirza Masrur Ahmedit,

mbajtur Gross Gerau të Gjermanisë më

28 maj 2004

Shpenzimi në rrugën e Allahut

Hazuri e filloi fjalimin e tij me recitimin e një ajeti nga Kurani i Shenjtë, përkthimin e të cilit do ta japë më poshtë. Ai më tutje vazhdoi duke thënë se, viti financiar i Xhematit përfundon më 30 qershor. Dy-tre muaj para kësaj, departamentet e financave të Xhematit fillojnë të brengosen rreth përmbushjes së buxhetit vjetor. Nga fundi, shqetësimet e tyre shtohen dhe ata fillojnë të shkruajnë letra duke kërkuar që të lutemi për ta, që deficitin në buxhet të eliminohet. **Shqetësimet** e tyre janë me vend, por neve gjithmonë na mbanë besimi i paluhatshëm, se pasi ky Xhemat është i themeluar nga Allahu, Ai më së miri i di nevojat tona dhe nga Mirësia e Tij, insha'allah, do t'i përmbushë ato nevoja. Por, është urdhër i Allahut që vazhdimisht t'ua përkujtojmë njerëzve, dhe nisur nga kjo, sot në fjalimin tim do të flas për këtë temë.

Allahu Ta'ala, në shumë ajete të Kuranit të Shenjtë, ua ka tërhequr vëmendjen besimtarëve rreth të shpenzuarit në rrugën e Allahut dhe e ka përmendur këtë si njërin nga shenjtat e besimtarit të vërtetë. Na ajetin e Kuranit që sapo e lexova, Allahu i madhërishtëm thotë se: ***"Ju nuk mund t'i arrini shkallët më të larta të besimit, përderisa të mos shpenzoni në rrugën e Allahut, nga pjesa më e dashur e pasurisë suaj"***.

Pra, deri sa të mos keni shpenzuar nga ajo pjesë e pasurisë suaj, ju nuk do të arrini atë status të lartë. Nuk duhet të mendoni se pasuria juaj është vetëm për ta shpenzuar për veten tuaj, ose për ta paluar në kasaforta të sigurta, si koprracët që madje nuk shpenzojnë as për familjet dhe fëmijët e tyre. Të tillët vazhdojnë të grumbullojnë pasuri deri në momentin e fundit të jetës së tyre, kur vdekja i ndanë prej saj dhe nuk mund të marrin asgjë me vete. Pasuria juaj dhe të ardhurat tuaja mujore, nuk mund të fshihen nga Allahu, pra, nuk duhet të mundoheni t'i fshihni nga Xhemati. Nëse dëshironi të keni bekimet e Allahut, ju gjithmonë duhet të jeni të sinqertë dhe të

paguani përqindjen e caktuar, në mënyrë që Allahu t'ju bekojë dhe të ju çoj përpara.

Hazret Musleh Maud r.a. (Kalifi i dytë) ka thënë lidhur me këtë se: *'Dobia e të shpenzuarit në rrugën e Allahut është se, besimtari i cili shpenzon, forcohet në besimin e tij. Prandaj shumë herë u kam thënë anëtarëve të Xhematit tim se, nëse dikush ndjehet i dobët në besimin e tij, dhe nëse nuk ka shumë, po të shpenzojë një pjesë të çfarëdo që ka në rrugë të Allahut, atëherë, Allahu do ta forcojë besimin e tij'*.

Transmetohet nga Ebu Hureira, r.a. se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë duke thënë se: *"Çdo mëngjes dy engjëj zbresin. Njëri prej tyre lutet: "O Allah jepi më shumë dorëllirit, dhe krijo më shumë njerëz që ecin rrugës së tij". Tjetri engjëll thotë: "O Allah shkatërroje koprracin me gjithë pasurinë e tij"*.

Me Mirësinë e Allahut, ka mijëra njerëz në Xhematin tonë që ecin gjurmëve të dorëllirëve dhe bujarëve. Mënyra se si duhet të punojnë është që të zvogëlojnë shpenzimet e tyre personale dhe të japin më shumë në rrugë të Allahut. Unë e di se shumë anëtarë të Xhematit mundohen t'i përmbushin këto standarde, por e di, gjithashtu, se ka edhe të atillë që nuk i llogarisin saktësisht të ardhurat e tyre e të paguajnë me përqindjen e duhur. Në Pakistan dhe në disa vende të tjera, pronarët e mëdhenj të tokave, shpesh ua ndalin ujin pronarëve të vegjël dhe si rezultat, pronarët e vegjël nuk mund të nxjerrin mjaft fitime nga tokat e tyre. Shumë prej jush që tani jeni vendosur këtu në Gjermani, vini prej familje bujqish dhe i dini mirë këto probleme. Prandaj, farmerët e vegjël nuk kanë shumë të ardhura, por pasi që i kanë bërë premtimet e tyre më herët ata nganjëherë mundohen të huazojnë para për të përmbushur premtimet e tyre ndaj Xhematit. Atyre shpesh u thuhet se nëse nuk keni fituar aq sa keni pritur, ju nuk jeni të obliguar të paguani aq sa keni premtuar, por ata thonë se pasi po huazojmë para për të përballuar shpenzimet tona, pse të mos huazojmë edhe për të përmbushur premtimet tona ndaj Xhematit. Ata shpresojnë se përmes kësaj, Allahu do t'i bekojë dhe herën tjetër do të kenë të ardhura më të mira. Kjo është çështje e tyre personale, ndërsa unë nuk ju them që të huazoni para dhe të kontribuoni për Xhematë. Ju nuk duhet ta ngarkoni veten tuaj mbi kapacitetet tuaja, por krejt çka kërkohet prej jush është që vetëm ta frenoni veten nga disa shpenzime të panevojshme që me lehtësi t'i përmbushni premtimet tuaja. Posaçërisht ata që e kanë bërë betimin e Vasijat-it ¹⁾ duhet të jenë shumë të kujdesshëm në përmbushjen e premtimeve të tyre. Ata nuk duhet të presin që Qendra t'ua përkujtojë këtë, dhe pasi t'u është përkujtuar, pastaj të paguajnë, sepse nëse nuk do të paguajnë për një kohë të gjatë, do të bëhet shumë e vështirë për ta, ta përmbushin premtimin. Disa shkruajnë dhe kërkojnë që të bëjmë lëshime për ta. Edhe nëse do të bëhen lëshime, nuk mund të bëhet për më shumë

1) Ata që paguajnë minimumin 10% të të ardhurave të tyre mujore. Këta quhen "musi".

se gjashtë muaj dhe nganjëherë masa duhet të ndërmerren kundër musive, pra, ata që marrin pjesë në vasijat. Ata duhet të jenë të kujdesshëm ndaj premtimeve të tyre dhe sa herë që të marrin të ardhurat e tyre, të paguajnë menjëherë pjesën që kanë premtuar. Kjo është po aq e rëndësishme edhe për ata që paguajnë Qandën Aam (kontributin e zakonshëm financiar që është një e gjashtëmbëdhjeta e të ardhurave personale, ose 6.25%).

Hazret Ebu Hurrera transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, s.a.s. duke thënë se: *"Një herë një njeri po udhëtonte nëpër shkretëtirë dhe papritmas e dëgjoji një zë prej qiellit i cili po e urdhëronte një re që të shkonte dhe të lëshonte shiun e saj mbi kopshtin e filan njeriut. Reja menjëherë iu bind zërit dhe filloi të shkonte kah i ishte thënë dhe me të arritur mbi kopsht, filloi të lëshonte shiun e saj. Aty po punonte një njeri. Udhëtari kureshtar e pyeti të zotin e kopshtit se si e kishte emrin. Emri i tij ishte po ai që e kishte dëgjuar nga zëri që e urdhëroi re. Kopshtari e pyeti se pse ishte kaq kureshtar që të mësonte emrin e tij? Ai tha se e dëgjova një zë nga qielli që e urdhëroi atë re që të vinte mbi kopshtin tënd. E përcolla dhe desha të dija se çfarë vepre të mirë ke bërë për të merituar një trajtim të tillë. Ai i tha: "E kam shprehur që një të tretën e bërës që marr nga kjo arë, e shpenzoj në rrugën e Allahut, një të tretën e shpenzoj për familjen time dhe pjesën tjetër e ruaj për farë për vitin e ardhshëm".*

Shumë anëtarë të Xhematit e praktikojnë që po sa të marrin rrogën, ose në rastin e farmerëve të vjelat, e ndajnë anash pjesën e caktuar që do ta japin për Allahun. Ose sa herë që bëjnë llogarinë e fitimeve të tyre, menjëherë e ndajnë pjesën që e kanë premtuar për Allahun. Kjo është rruga më e mirë, sepse po të lihet për më vonë, do të bëhet ngarkesë e madhe për ta që të paguajnë një shumë kaq të madhe për njëherë. Veç kësaj, ajo që paguhet me vonesë kurrë nuk e ka vlerën e asaj që paguhet me kohë.

Dobia tjetër që kanë ata që janë të rregullt është se, Allahu i bekon ata dhe shpesh edhe ata vetë mahniten se prej nga po vinë gjithë ato të mira. Allahu e ka mënyrën e Vetë kur dëshiron t'i dhurojë dikujt diçka dhe njeriu shpesh nuk mund ta kuptojë se si ndodhë. Allahu i Madhërishëm thotë se nëse shpenzoni në rrugën Time, Unë do t'ua rikthej atë që keni shpenzuar shtatëdhjetë fish, madje edhe më shumë. Thesaret e Tij nuk kanë limite. Pra, ju duhet të jeni gjithmonë shumë të pastër në punët dhe tregtitë tuaja. Pastroni kursimet tuaja dhe pastaj do ta shihni se si do të zbresin bekimet e Allahut mbi ju.

Disa mendojnë se pasi që ekziston një rregull në Xhematë se, për t'u zgjedhur në ndonjë post, anëtari nuk duhet të ketë ngelur mbrapa me pagesën e kontributit financiar për më shumë se gjashtë muaj, ata mendojnë se nuk prishë punë nëse do ta vonojnë pagesën deri në fund të

afatit. Ata duhet ta dinë se kjo rregull është bërë kryesisht për ata që i marrin të ardhurat e tyre një herë në gjashtë muaj, pra, kryesisht për bujqit. Ndërsa ata që marrin rroga mujore, ata duhet t'i kryejnë obligimet e tyre për çdo muaj, e të mos i lënë të grumbullohen e të shndërrohen në barrë të papërballueshme. Përveç kësaj ata ndjehen edhe të turpëruar për shkak të vonesës. Gjëja më e rëndësishme për ta mbajtur mend është se bekimet e Allahut fitohen duke u treguar i rregullt në kryerjen e obligimeve, pastaj vetvetiu edhe bekimet e Allahut pranohen në mënyrë të rregullt. Ata që kanë vështirësi të kontribuojnë me një të gjashtëmbëdhjetën, për ta ka lehtësim që nëse me të vërtetë nuk kanë, mund të shpenzojnë më pak. Por, ata duhet të jenë të sigurtë. Këtu, dua t'ua tërheq vërejtjen kryetarëve të Xhematëve dhe sekretarëve të financave, që të mos i bëjnë publike çështjet personale të njerëzve. Kjo nuk duhet të ndodhë. Nëse dikush nga anëtarët kërkon lehtësim të përkohshëm në kontributin e tij financiar, atëherë, nuk është e hijshme që kjo të bëhet publike. Në fakt, unë e kam vërejtur se shumica e këtyre anëtarëve që kanë kërkuar lehtësim të përkohshëm në kontributet e tyre, janë shumë të ndjeshëm dhe mundohen brenda mundësive të tyre, t'i përmbushin premtimet e tyre në përqindjen e duhur. Ka shumë të tillë, ndërsa ata që nuk janë të kategorisë së tyre, duhet t'i kushtojnë vëmendje kësaj çështjeje. Është shumë e rëndësishme që secili ta analizojë gjendjen e vetë financiare, kështu që me t'u përmirësuar kjo gjendje, ata të fillojnë të paguajnë përsëri me përqindjen e duhur. Na dhëntë mundësinë Allahu, secilit prej nesh që ta bëjmë këtë. Amin!

Ka disa që në një moment të caktuar e humbin vendin e punës, ose në biznesin e tyre papritmas gjithçka shkon keq dhe fabrika ose punëtoria duhet të nxirret në shitje; ose ka edhe shembuj të tjerë, siç e ceka më lartë rastin e bujqve. Pra, ka shumë faktorë. Në jetë këto gjëra janë të zakonshme dhe shpesh mund të ndodhin për shkak të gabimeve të njerëzve; por kjo është një temë tjetër. Në situata të tilla nuk duhet ta humbni shpresën, por duhet vazhdimisht të mundoheni të bëni diçka, qoftë edhe ndonjë punë të vogël, deri sa të gjeni ndonjë punë më të mirë. Ka shumë të atillë që janë dëshpëruar dhe i kanë humbur të gjitha shpresat. Të tillët duhet të mbështeten në Allahun e Madhërishtëm dhe të kërkojnë ndihmën e Tij. Çfarëdo pune që është në dispozicion duhet ta pranojnë dhe nuk duhet ta konsiderojnë ndonjë lloj pune ofenduese për ta dhe nën nivelin e tyre. Nëse me qëllim të mirë dhe pozitiv e pranojnë ndonjë punë dhe e lusin Allahun Ta'ala: "O Allah! Për ta përmbushur premtimin tim ndaj Xhematit dhe për ta dhënë kontributin tim, bekoje këtë punë për mua"! Atëherë Allahu e bekon punën e tyre. Kam parë njerëz që për një kohë kanë pasur vetëm një tezgë skaj rrugës dhe më pas janë bekuar në atë mënyrë që më pas janë bërë pronarë të bizneseve të mëdha. Është, pra, qëllimi i juaj që bekohet nga Allahu Ta'ala (Lartë).

Transmetohet nga Hazret Ebu Masud Ansari se: *"Sa herë që Hazret Muhamedi s.a.s. na këshillonte të jepnim sadakë, shumë prej nesh dilnim dhe kërkonim ndonjë punë dhe prananim çfarëdo pune dhe edhe nëse fitonim vetëm disa hurma ato i jepnim në sadaka. Të njehët që në kohën e Profetit të Shenjtë pranonin punë të tilla fizike, tani posedojnë thesare të mëdha".*

Këta nuk janë shembuj që kanë ndodhur vetëm në kohën e Profetit të Shenjtë s.a.s., këto ndodhin edhe në ditët tona. Ata që kanë dhënë në rrugën e Allahut një shumë të vogël, Allahu i ka bekuar pa masë. Transmetohet nga Hazret Ebu Dhar Ghafari r.a. se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë se: *"Devotshmëri e vërtetë nuk është që gjithçka që është e lejueshme ta japësh dhe ta shkatërrosh pasurinë tënde, apo t'i shmangesh pasurisë. Devotshmëri e vërtetë është që të kesh besim në Allahun, duke qenë i pasur. Mos u mbështet në pasurinë tuaj, por në Allahun. Allahu duhet të jetë siguria juaj. Qëllimet tuaja duhet të jenë të sigjerta; gjithmonë të jesh i përlurur para Allahut dhe gjithmonë ta lutësh Allahun për mbrojtje. Nëse ju ndodhë ndonjë e keqe, duhet ta konsideroni si një burim i faljes për ju; përmes asaj Allahu do t'ju falë. Pra, në vend që të ankoheni, ose ta mohoni Allahun dhe në vend që ta humbësh gjithë shpresën, duhet të përulesh para Allahut të Madhërishëm; dhe pastaj Allahu do të lirojë nga ajo vuajtje me nder".*

Pra, nëse gjithmonë rrini të përlurur para Allahut dhe nëse gjithmonë i luteni Atij, atëherë do ta shihni se sa shumë bekime Allahu do t'ju dhurojë. Këto bekime do t'i shihni në këtë botë dhe në botën tjetër; dhe gjithashtu do t'i shihni ato bekime në gjeneratat e ardhshme të këtyre njerëzve. Pra, kurrë mos u dëshpëroni në Allahun dhe kurrë mos iu ankoni Atij. Ju duhet t'i përluleni Allahut Ta'ala dhe të kërkonin ndihmën e Tij dhe të plotësoni kërkesat e adhurimit sa më mirë.

Në një transmetim tjetër thuhet se i Dërguari i Allahut i tha kunatës së tij Asma bint Abi Bakër: *"Mos i numëro ato që i shpenzon në rrugën e Allahut, sepse edhe Allahu do t'i numërojë ato që t'i jep ty. Mos u bë dorështrënguar, sepse do të trajtohesh në të njëjtën mënyrë".*

Pra, ju duhet të shpenzoni dorëhapur në rrugën e Allahut dhe pa i numëruar. Elhamdulillah, anëtarët e Xhematit tonë gjithmonë kanë shpenzuar dhe shpenzojnë dorëhapur. Këto ditë, gjatë takimit vjetor të rinjve në Gjermani, lidhur me ngecjen mbrapa në plan-programin e ndërtimit të njëqind xhamive në këtë vend, u thashë të rinjve se ata duhet të tregohen më të vëmendshëm në mbështetjen e këtij programi; dhe vetëm të nesërmen, ata kishin mbledhur premtime për 1 milion Euro dhe

premtimet që kishin bërë më parë për të mbledhur 250 mijë Euro brenda një viti gati i kishin plotësuar vetëm brenda një jave. Shembulli i zbrazjes së kuletave në rrugë të Allahut mund të shihet shpesh në Xhemat. Një anëtar i dedikuar, na ka lutur që ta lejojmë të mbulojë të gjithë koston e ndërtimit të një xhamie me gjithë blerjen e tokës. Ka shumë në Xhematë që ndërmarrin përgjegjësi të mëdha; Allahu i bekoftë ata. Por, sot jam duke folur për kontributet e rregullta mujore dhe dua ta bëjë të qartë se kontributet shtesë që dëshironi t'i jepni, nuk duhet të ndikojnë në kontributet tuaja të rregullta, sepse kontributet e rregullta nuk guxojnë të preken. Çdo shumë shtesë që ju e ofroni është në vete dhe Allahu do ta bekojë atë, insha'allah.

I Dërguari i Allahut, s.a.s. shpenzonte në rrugën e Allahut dhe i përgëzonte me lajme të mira ata që shpenzonin në rrugën e Allahut. Secili besimtar merakoset se si do të trajtohet në Botën e Ardhshme. Ata që shpenzojnë në rrugën e Allahut, Profeti i Shenjtë i ka liruar nga kjo brengë. Ai tha se: *"Në ditën e Gjykimit ata që kanë shpenzuar në rrugën e Allahut, do të pushojnë nën hijen e shpenzimeve të tyre"*. Ai gjithashtu e ka bërë të qartë se ky shpenzim duhet të jetë vetëm për hir të Allahut dhe vetëm për të fituar dashurinë e Allahut. Allahu na bëftë nga ata që shpenzojnë në rrugën e Allahut vetëm për hir të Allahut.

Ka edhe një kontribut të rëndësishëm financiar, rreth të cilit dëshiroj t'ua tërheq vëmendjen dhe ky është Zekati. Zekati e ka një përqindje të caktuar të cilën duhet paguar. Shumë njerëz nuk i kushtojnë rëndësi kësaj. Për bujqit që nuk paguajnë taksa, zekati është i detyrueshëm. Edhe ata që mbajnë para në bankë, edhe ata duhet të paguajnë zekat për atë shumë të parave që e mbajnë në bankë. Edhe për stolitë që gratë i mbajnë, duhet paguar zekat. Secila grua ka stolitë e saja. Thuhet nganjëherë se nëse ato herë pas here ua huazojnë stolitë e tyre grave të tjera, atëherë nuk duhet të paguajnë zekatë për to, por në ditët tona kjo praktikë po bëhet gjithnjë e më e rrallë. Pra, se a i huazojnë ato apo i përdorin vetëm për vete, ato duhet të jenë të kujdesshme në këto gjëra. Mesihu i Premtuar, a.s.s. ka thënë për gruan e tij Hazret Nusret Xhahan Begëm Sahiba, se ajo gjithmonë paguan zekatin e stolive të saja megjithëse ua huazon nganjëherë grave të tjera. Shumica e këtyre amviseve që nuk kanë të ardhura personale, duhet të kërkojnë ndihmë prej burrave të tyre për të paguar zekatin. Në kohët e hershme të Islamit, sa herë që kishte ndonjë nevojë për të kontribuar për çështje të fesë, krahas pagesës së rregullt të zekatit, sahabët kontribuonin dorëhapur. Pra, me gjithë faktin se në Xhematë është i organizuar sistemi i kontributeve financiare dhe ky kontribut është shumë më i madh se sa përqindja e zekatit, krahas kësaj ju duhet të jeni të përpiktë në paguarën e zekatit sipas përqindjes së caktuar; e kjo vlen posaçërisht për femrat që të paguajnë zekatin e stolive të tyre.

Hazret Amar Bin Shuaib transmeton nga gjyshi i tij, se: *"Një herë një grua erdhi me të bijën e saj te i Dërguari i Allahut, s.a.s. Vajza e saj mbante në dorë hallka të rënda ari. Profeti i Shenjtë e pyeti se a paguante ajo zekat për këta byzylykë? Ajo tha jo, o Profeti i Allahut. Profeti i tha: 'A dëshiron që Allahu të të vë byzylykë zjarri në duart tuaja në Ditën e Gjykimit?' Në atë moment gruaja ia hoqi të bijës hallkat nga dora dhe ia dha Profetit si zekatë".*

Mesihu i Premtuar a.s. thotë: *'O ju myslimanë! Unë ju them se këtë Xhematë të cilin e ka themeluar Allahu Ta'ala, ju duhet ta mbështetni me sinqeritet të plotë dhe ta nderoni dhe t'i përmbushni të gjitha kërkesat që ju bëhen. Ai që dëshiron të kontribuojë, duhet ta bëjnë atë rregullisht për çdo muaj; dhe për hir të Allahut duhet të jetë vigjilent në këto kontribute dhe nuk duhet të tregohet i shkujdesur. Nëse dikush dëshiron të japë herë pas here ndonjë shumë më të madhe, mund ta bëjë këtë, por ju duhet ta mbani mend se kontributet e rregullta janë të domosdoshme për funksionimin normal të çdo organizate. Përveç nëse dikush pëson ndonjë aksident, përndryshe kontributet tuaja duhet të jenë të rregullta. Nëse dikush, të cilit Allahu i ka dhënë më shumë pasuri, për të fituar kënaqësinë e Allahut, dëshiron të paguajë edhe jashtë kontributit të rregullt, ai mund ta bëjë këtë".*

"O ju të dashurit e mi! - thotë Mesihu i Premtuar, a.s. - ju që jeni duke shpenzuar në rrugën e Allahut, e di se sa herë që kam bërë ndonjë kërkesë, ju gjithmonë jeni përgjigjur dorë lirshëm. Unë nuk dua ta caktoj shumën që ju do ta paguani, sepse ju duhet të jepni sipas mundësive tuaja".

Përqindja e caktuar, thotë Kalifi, që paguajmë tani, është caktuar në kohën e Kalifit të dytë i cili e kishte caktuar këtë përqindje duke u bazuar në fjalët e Mesihut të Premtuar, a.s. që kontributet e rregullta mujore janë të domosdoshme për funksionimin e Xhematit.

Hazuri tha se siç e kam përmendur edhe më parë, është shumë e rëndësishme që sakrificat tuaja të jenë vetëm për hir të Allahut dhe jo për t'u treguar para njerëzve. Ju gjithashtu duhet të jeni mirënjohës ndaj Allahut të Madhërishëm që ua ka dhënë mundësinë që të merrni pjesë në këto projekte dhe në kontributet tuaja të rregullta. Është vetëm Allahu që mund ta japë këtë mundësi. Mesihu i Premtuar, a.s. thotë se: "Nuk është e mundshme për ju që të mbani dy dashuri në zemrat tuaja: dashurinë për Allahun dhe dashurinë për pasurinë tuaj. Në zemër ka vend vetëm për një dashuri. Fatlum është ai i cili e zgjedh Zotin dhe e do vetëm Atë. Pra ai i cili e zgjedh Allahun dhe shpenzon në rrugën e Tij nga pasuria që Ai ia ka dhënë, unë jam i sigurt se Allahu i Madhërishëm do ta bekojë pasurinë e tij, sepse pasurinë ju nuk mund ta mblidhni vetë me forcat tuaja, por ajo vjen nga Allahu".

Pra, ai i cili e ndanë një pjesë të pasurisë së tij për hir të Allahut, sigurisht që do t'i kthehet e bekuar nga Allahu i Madhërishëm.

Nëse secili mendon se nga fitimet ose të ardhurat e mia, pesëmbëdhjetë pjesë janë të miat dhe një është për Allahun, Allahu sigurisht do ta bekojë atë person dhe pasurinë e tij. Ndërsa ai i cili e do pasurinë dhe nuk i bën ato shërbime që duhet t'i bëjë në rrugën e Allahut, ai sigurisht do ta humbë pasurinë e tij. Mesihu i Premtuar a.s. thotë se: *"Ata që mendojnë në këtë mënyrë, atyre nuk do t'u ecin punët mbarë dhe përfundimisht do ta humbasin pasurinë e tyre; sepse pasurinë që e keni, e keni prej Allahut. Mos mendoni se me shërbimet dhe sakrificat tuaja ju jeni duke i bërë ndonjë shërbim Allahut. Unë ju them se edhe nëse të gjithë ju më braktisni, Allahu do ta sjellë një popull tjetër në vendin tuaj, që do t'i përmbushin më mirë detyrat e tyre në rrugën e Allahut. Ajo që po kërkohet prej jush është për të mirën tuaj, pra mos u bëni arrogantë dhe mendjemëdhenj e të mendoni se me shërbimet tuaja jeni duke i bërë ndonjë të mirë Allahut, përkundrazi, Allahu është duke u bërë mirë juve që u ka dhënë këtë mundësi".*

Allahu na mundësoftë që t'i përmbushim të gjitha këto detyrime që priten prej nesh e të futemi nën mburojën e lutjeve të Mesihut të Premtuar, a.s. dhe të jemi nga ata që janë në gjendje të bëjnë këto sakrifica. **Amin!**

Note:	This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of:
28 May 2004	The topic of this Khutba is: "Spending in
the way of Allah"	This translation has been prepared by the members of Kosovo Jam'aat